



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe nenit 12 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, Kryetari i Komunes, duke vendosur sipas kërkesës së Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale të datës 07.12.2020, nxjerr:

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1200 € (një mijë e dyqind euro), Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale për ta mbështetur financiarisht në kërkesën e saj, sipas së cilës është planifikuar të blehen dezinfektues dhe maska për nëpunësit civil të Administratës Komunale si masë mbrojtëse në vendin e punës në këtë kohë të përballjes me pandeminë COVID 19.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021, kategoria e subvencioneve në xhirollogarinë bankare të SHSPAK nr. 140100000845825 në Bankën Ekonomike .

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara Shoqata Sindikale duhet të sjell dëshmi –faturë mbi shpenzimin e mjeteve dhe të njëjtat dorëzohen në Zyrën e Kryetarit të Komunës- Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet SHSPA në Lipjan.

1Nr. 400-18582
Lipjan, më 08.04.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

